



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 1297/ 14 Prot.

Tiranë, më 30.04.2018

## V E N D I M

Nr. 37, datë 30. 04 .2018

### PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË RROGOZHINË “PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË” PËR PERIU DHËN 01.01.2016 DERI 31.12.2017.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë rezultoi që të ketë devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), gjatë aktivitetit të zhvilluar në periudhën në auditim, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë, për periudhën 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1 - Gjetje nga auditimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Rrogozhinë, për vitin 2016, nuk ka pasqyruar saktë **llogarinë 212 (Ndërtime e konstruksione)** nga marrjen në dorëzim e banesave sociale të ndërtuara me fonde publike me vlerë 8,008,884 lekë, nuk ka pasqyruar saktë **llogarinë 214 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”**, për rehabilitimin e kanaleve ujitëse sekondar Peqin-Kavajë me vlerë 47,735,768 lekë; Rivitalizimin urban i Qendrës së Qytetit me vlerë 124,986,479 lek dhe Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit loti i parë me vlerë 27,408,463 lekë. Nuk ka pasqyruar saktë **llogarinë 218 (Inventar ekonomik)** nga blerja e aktiveve nga prokurimet me vlera të vogla.

Komisioni i inventarizimit **nuk ka hartuar një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, aktivet që vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit, si dhe **nuk janë bërë hyrje në magazinë**, veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, pika 3 e VKM nr. 248 date 10.04.1998 “Për Miratimin e Planit Kontabël Publik”, të ndryshuar me VKM nr. 25 date 20/01/2001 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë” dhe pikën 35, germën c pika 36, 37, 39, 40, 85, 103, 104, 106, 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 15-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 - Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masat e mëposhtme:

**a.** të bëjë rregjistrimet kontabël duke pasqyruar me saktësi llogarinë 212 (Ndërtime e konstruksione) me vlerë 8,008,884 lekë, për banesat sociale, llogarinë 214 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, me vlerë 47,735,768 lekë për rehabilitimin e kanaleve ujitëse sekondar Peqin-Kavajë; Rivitalizimi urban i Qendrës së Qytetit me vlerë 124,986,479 lek dhe Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit loti i parë me vlerë 27,408,463 lekë dhe llogarinë 218 (Inventar ekonomik) nga blerja e aktiveve nga prokurimet me vlera të vogla.

**b.** procesi i inventarizimit të mos jetë një procedurë formale por të respektohen të gjitha kërkesat që e bëjnë një proces të kujdesshëm, të kontrolluar dhe që krijon mundësi për administrim të kujdesshëm të aktiveve duke rritur dhe përgjegjësin për personat e përfshirë në këtë proces.

## Në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi.** Në auditimin e kryer për administrimin e aseteve në Bashkinë Rrogozhinë, u konstatua se ky proces nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenit 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, neni 6, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimi nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”, kjo për shkak të funksionalitetit të munguar të zyrës së menaxhimit të aseteve (për prona publike, objekte, toka, troje, rrugë, pyje, kullota, etj.), strukturë e cila duhet të realizonte **administrimin dhe menaxhimin e aseteve për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV<sup>ve</sup>** për vënien në efikasitet të ndërtesave të zëna **me sipërfaqe gjithsej 1195 m<sup>2</sup>**, të trojeve të lira me **sipërfaqe gjithsej 8892m<sup>2</sup>** dhe tokë bujqësore produktive dhe jo produktive **me sipërfaqe gjithsej 2303 ha**, për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tyre (*Trajtuar hollësisht në faqet 97-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për krijimin e një njësie funksionale të menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në Rregulloren e Brendshme detyrat konkrete për inventarizimin, evidentimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP, si dhe krijimin e regjistrimit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë, për vënien në efikasitet të ndërtesave të zëna **me sipërfaqe gjithsej 1195 m<sup>2</sup>**, të trojeve të lira me **sipërfaqe gjithsej 8892m<sup>2</sup>** dhe tokë bujqësore produktive dhe jo produktive **me sipërfaqe gjithsej 2303 ha**, për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e tyre .

## Menjëherë

**3-Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Financës, sistemi kompjuterik nuk e ka të certifikuar nga kompani e licencuara për ruajtjen e të dhënave, pasi sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave. Mos certifikimi i sistemit kompjuterik për mbrojtjen e të dhënave dhe të integritetit të tyre,

vjen në papajtueshmëri me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” (*Trajtuar hollësisht në faqet 15-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 – Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike.

#### Në vijimësi

**4 - Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, për vitin 2016-2017, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në shumën 47,897,308 lekë, nga të cilët debitor nga tatim taksat në shumën 25,719,216 lekë dhe gjoba e penalitete në shumën 22,178,092 lekë dhe në fund të viti 2017 nuk ka shlyer detyrimet kreditore në shumën 54,598,827 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 germa g, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 15-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1 - Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në vlerën **47,897,308 lekë**, nga të cilët debitor nga tatim taksat në shumën **25,719,216 lekë** dhe gjoba e penalitete në shumën **22,178,092 lekë**.

**4.2 - Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të bëjë shlyerjen e detyrimeve kreditore në vlerën **54,598,827 lekë**, brenda afateve ligjore.

#### Brenda muajt Dhjetor 2018

**5 - Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se administrimi i mallrave të blera nuk është bërë në përputhje me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Sektori i Financës në Bashkinë Rrogozhinë, konstatohet se nuk ka marrë masa për të bërë hyrje në magazinë mallra si më poshtë konstatuar, sipas faturës tatimore nr. 3 dhe 4, datë 08.02.2016, nuk ka bërë hyrje në magazinë 4 copë tavolina me vlerë **60,000 lekë** dhe 4 dollap me vlerë **60,000 lekë**, sipas faturës tatimore nr. 57, datë 22.04.2016,

Nuk ka bërë hyrje në magazinë pompë uji me çmim **85,208 lekë**, Pompën zhytëse me vlerë **517,380 lekë** dhe motopompën e vjetër si material jashtë përdorimit e cila është zëvendësuar me pompën e re. Sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 13, datë 01.07.2016 nuk ka bërë hyrje në magazinë magnetofon copë 3 me vlerë **88,500 lekë** dhe ventilator copë 1 me vlerë **5.500 lekë**, sipas faturës tatimore nr. 10, datë 26.09.2016 nuk ka bërë hyrje në magazinë tavolina për Bibliotekën me vlerë **624,600 lekë**, sipas faturës tatimore nr. 15, datë 21.12.2016 nuk ka bërë hyrje në magazinë pompë me vlerë **67,200 lekë**, sipas faturës tatimore nr. 63, datë 11.02.2017, Ekskavator me zinxhirë marka VOLVO, Model EC88D me vlerë **9,055.196 lekë**, veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 - Rekomandim:** Të nxirret përgjegjësia për mos veprim në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe të eliminohen praktika që lënë shteg për shpërdorim të mallrave të blera.

Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa, të bëjë hyrje në magazinë 4 copë tavolina me vlerë **60,000 lekë** dhe 4 dollap me vlerë **60,000 lekë**, pompë uji me çmim **85,208 lekë**, pompën zhytëse me vlerë **517,380 lekë** dhe motopompë e vjetër si material jashtë përdorimit, magnetofon copë 3 me vlerë **88,500 lekë** dhe ventilator copë 1 me vlerë **5.500 lekë**. Tavolina për Bibliotekën me vlerë **624,600 lekë**, pompë me vlerë **67,200 lekë** dhe Ekskavator me zinxhirë marka VOLVO, Model EC88D me vlerë **9,055.196 lekë**.

#### Brenda muajt Qershor 2018

**6 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë në 3 raste me vlerë **941,999 lekë**, ka zhvilluar aktivitete kulturore dhe artistike pa hartuar program, pa përcaktuar fondin limit dhe datën përfundimtare për

*paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë, nuk kanë ngritur komisioni për të kërkuar oferta nga operatorët e specializuara, për të përcaktuar kushtet e veçanta, si dhe për të hartuar një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin duhet t'ia paraqiste titullarit të institucionit, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (Trajtuar hollësisht në faqet 15-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, për aktivitetet kulturore dhe artistike të hartoj program pune, të përcaktoj fondin limit dhe datën përfundimtare për paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë. Komisioni të kërkojë oferta nga operatorë të specializuara, si dhe të hartojë një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin t'ia paraqes titullarit të institucionit.

#### Në vijimësi

**7 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë në 4 raste, ka marrë me qira nga persona privat pasuri të paluajtshme, **duke mos bërë një analizë financiare kosto-përfitim**, në kuptimin e një studimi fizibilitetit, duke krahasuar koston e marrjes me qira + koston e mirëmbajtjes, duke mbajtur në konsideratë diferencën e koston me çmimin. Bashkia Rrogozhinë, nuk ka përcaktuar kushtet ose termat e referencës për ambientet që marrte me qira me çmimin e referencës për zona të ndryshme të qytetit, si dhe domosdoshmërisht për një proces konkurrues nuk ka bërë publikimi në televizionin lokal, në gazetën më të shitur dhe nuk ka kërkuar të paktën tre oferta përpara vendimmarrjes, veprim në kundërshtim me kreun IV neni 31 pika 1 dhe neni 33, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 15-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, për pasuritë e paluajtshme që do të marrë me qira nga persona privat të bëjë një analizë financiare kosto-përfitim, në kuptimin e një studimi fizibilitetit, duke krahasuar koston e marrjes me qira + koston e mirëmbajtjes, duke mbajtur në konsideratë diferencën e koston me çmimin, të përcaktojë kushtet ose termat e referencës për ambientet që marrte me qira me çmimin e referencës për zona të ndryshme të qytetit, si dhe domosdoshmërisht për një proces konkurrues të publikojë në televizionin lokal dhe në gazetën më të shitur dhe të kërkojë të paktën tre oferta përpara vendimmarrjes.

#### Në vijimësi

**8 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, nga **14 masa** organizative ka zbatuar **4 masa**, në proces **2 masa** dhe pa zbatuar **8 masa**. Nuk janë zbatuar masa nr. 1, për arkëtimin e shumës **5,370,986 lekë** dhe shumës **21,225,465 lekë** për subjektet debitorë; masa nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 për 22 subjekte të palicencuara në shumën 607,160 lekë.

Nga **8 masa** shpërbllim dëmi **nuk ka zbatuar 8 masa** në shumën **5,660,962 lekë** dhe konkretisht: masa nr. 1 në shumën 1,247,850 lekë nga sportistë të pa federuar; masa nr. 2 në shumën 60,000 lekë nga OE “B. T.” në shërbimin e internetit; masa nr. 3, në shumën 2,011,000 lekë nga OE “E. Shpk”; masa nr. 4, në shumën 74,461 lekë nga Shoqëria M. Shpk; masa nr. 5 në shumën 873,072 lekë nga B. N.; masa nr. 6 në shumën 13,288 lekë nga “M. Shpk” në shumën 37,101 lekë; masa nr. 8 në shumën 1,343,790 lekë nga anëtarët e këshillit të baskisë dhe nga **14 masa** disiplinore **nuk janë zbatuar 14 masa**, veprim në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” (Trajtuar hollësisht në faqet 13-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lëna nga KLSH-ja dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës 32,257,413 lekë.

#### Brenda muajit Maj 2018

**9 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, për periudhën 01.01.2016 deri me datë 31.12.2017, shërbimin e transportit të punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, pasi kishte zhvilluar dy herë proceduar prokurimit të hapur dhe kishte dështuar, e ka bërë

me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, **ndërsa duhet të bënte mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt**, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë dhe në Zyrat e Postare.

Për periudhën 29.08.2017 deri me datë 31.12.2017, **ka bërë lidhjen e kontratave të shërbimit për transportin e punonjësve arsimorë dhe të nxënësve me vlerë 4,599,100 lekë, pas datës 01.07.2017, pasi këtë procedurë duhet ta zhvillonte Zyra Arsimore Kavajë**, veprim në kundërshtim me nenin 30, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me VKM nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 03.05.2017, pika 3 (Trajtuar hollësisht në faqet 30-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa që në të ardhmen shërbimin e transportit të punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, ta bëjë duke mbuluar shpenzimet për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë ose në Zyrat Postare dhe të mos lidhi kontrata shërbimi në kundërshtim me akteve ligjore e nënligjore në zbatim.

#### Në vijimësi

**10 - Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Rrogozhinë dhe Njësitë Administrative Lekaj, Gosë, Kryevidh dhe Sinaballaj, në fund të vitit 2017 janë debitorë për taksë dhe tarifa vendore 314 subjekte në shumën **25,719,216 lekë** dhe familjarët në vlerën 96,298,783 lekë (5462 familje për taksë toke në vlerën 74,825,500 lekë, 4535 familje për Taksë ndërtese në vlerën 10,595,534 lekë dhe 4640 familje për tarifa të vendore në vlerën 10,877,750 lekë). Sektori i Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 - Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 314 subjekte debitorë në shumën **25,719,216 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme sipas Aneksit 7 dhe 8:

**a** - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**b** - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**c** - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjohë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**10.2 - Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të hartojë listën elektronike për abonentët familjare, si dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **96,298,783 lekë**, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me Postë, për:

- Taksë toke, për 5462 familje me vlerë 74,825,500 lekë;
- Taksë ndërtese, për 4535 familje me vlerë 10,595,534 lekë;
- Tarifa vendore, për 4640 familje me vlerë 10,877,750 lekë;

#### Në vijimësi

**11- Gjetjet nga auditimi:** Në Bashkinë Rrogozhinë, kanë ushtruar aktivitetet 6 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën **246,640 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 - Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Rrogozhinë të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 6 subjekteve në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën **246,640 lekë**, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Rrogozhinë ushtrojnë aktivitet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore 22 subjekte për sipërfaqe 21.2 ha, janë lidhur kontratë qiraje, për sipërfaqe 17.3 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” (*Trajtuar hollësisht në faqet 102-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandimi:** Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit në Bashkinë Rrogozhinë, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se për subjektet të cilët kanë ndërtuar pa leje janë mbajtur **25 vendime administrative** (me gjobë) në vlerën **2,250,000 lekë**, vlerë kjo e pa kontabilizuar në librat e llogarive të Bashkisë Rrogozhinë dhe pa ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e gjobave, veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, nenet 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”, ligjin nr. 9228, datë 29/4/2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Po kështu Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), nuk ka ndjekur procedurat dhe kërkuar në Gjykatë për rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 24, 30 dhe 43, ku edhe pse sipas këtij të fundit për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative organet e administratës përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave gjyqësore, pasi këto përballohen nga kundërvajtësi (*Trajtuar hollësisht në faqet 93-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 - Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe Sektorin Juridik në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kontabilizim e gjobave dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e gjobave nga 25 subjekte në vlerën **2,250,000 lekë**, për kryerje të punimeve pa leje ndërtimi. Po kështu të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë të vendosura gjatë viteve, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kryer të 16 dosjeve të kontratave për procedurën e ndjekur nga Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara (KQTBP) për dhënien me qira të tokave shtetërore të pandara, për sipërfaqen **27.6 ha**, u konstatua se: Kryetari i Bashkisë z. N. D. me urdhrin e

brendshëm nr. 14, datë 20.11.2013, protokolluar me nr. 530, datë 20.11.2013 ka urdhëruar, ngritjen e komisionit për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, ndërsa vendimet “Për dhënien me qira të tokave Bujqësore të pandara”, janë marrë me datë 08.11.2013 dhe kontratat mbajnë datën 12 .11.2013 dhe 13.11.2013, pra 8 ditë më përpara se është ngritur ky komision.

Në dosjen e kontratave mungon, shpallja publike e Bashkisë Rrogozhinë, si dhe njoftimi, data, vendi dhe ora e zhvillimit të procedurës së garës, për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, dokumentacioni në lidhje me Vendimin për klasifikimin dhe pikët e kërkesës të shqyrtuara së bashku me arsyetimet përkatëse, si dhe në dosje nuk ndodhet shpallja e vendimit dhe njoftimi i subjektit përkatës, informacioni në lidhje me teknologjinë kryesore që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, përpunimi i produkteve, investimet kryesore mbi infrastrukturën (si kullim, ujitje, sistemimin etj.), investimet e lidhura me mbjelljen e bimëve, burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare; ndikimin e investimit në rritjen e numrit të punësuarve në Bashkinë Rrogozhinë. Kërkesat e ardhura nga fermerët nuk janë protokolluar në zyrën e Protokollit të Bashkisë Rrogozhinë, në 5 raste Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara nuk ka respektuar afatin për shpalljen e procedurës së garës e cila duhet të mbyllet brenda 30 ditëve.

Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara nuk ka respektuar madhësinë e sipërfaqes së tokës që jepet me qira për afatin prej 99 vjetësh, e cila nuk mund të jetë nën 1 ha. Në 14 raste, Vendimi i KQTBP-së për dhënien me qira të tokës bujqësore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, veprime në papajtueshmëri me nenin 5, ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", pikës 4 të vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara", të ndryshuar, kreu II pika 1, 3, 11, kreu IV, germa c, të UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” (*Trajtuar hollësisht në faqet 105-131, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë, Sektori Juridik, të marrë masa për ndërprerjen e kontratave, për dhënien me qira të tokave shtetërore të pandara pa procedurë konkurrimi.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dosjeve të kontratave për dhënien me qira të hapësirës së plazhit, me sipërfaqe 68674 m<sup>2</sup>, u konstatuan se: Bashkia Rrogozhinë, nuk ka marrë konfirmimin nga ministria përgjegjëse për turizmin nëse hapësira e plazhit të kërkuar është objekt i ndonjë kërkesë që është duke u shqyrtuar apo një kontrate në kuadër të ligjit nr. 55/2015, datë 28.05.2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", ose është objekt i ndonjë kërkesë apo kontrate për vënien në dispozicion të hapësirës së plazhit për investitorët në zonat me përparësi turizmin, në dosjet e kontratave **mungon** dokumentacionit tekniko-ligjore si: plani i biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve, dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, harta e hapësirës së plazhit të dhënë me qira, procesverbali i marrjes në dorëzim të hapësirës së plazhit, sipas kontratës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93/2015, datë 27.07.2015 "Për Turizmin", pikat 1, 2, të nenit 64, dhe VKM nr. 369, datë 18.5.2016 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", pika 3, 4, nenit 4, pika 3, 5 të nenit 6 dhe pika 3 e nenit 9 (*Trajtuar hollësisht në faqet 105-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë, Sektori Juridik, të marrë masa për ndërprerjen e kontratave, për dhënien me qira të hapësirës së plazhit, të cilave në dosje u mungon dokumentacionit tekniko-ligjore sipas kërkesave të ligjit, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Sipërmarrësi “C. R. 2008” sh.p.k për objektin “Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit Rrogozhinë”, ka realizuar punime me vlerë 1,542,300 lekë me tvsh, kryesisht në punimet e shtresave të pllakave dhe guardrail, jo sipas specifikimeve të preventivit dhe projektit(*Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Rrogozhinë dhe sipërmarrësi “C. R. 2008” sh.p.k të marrin të gjitha masat për zëvendësimin e pllakave dhe handrailit dhe vendosjen e tyre sipas specifikimeve teknike të projektit dhe situacionit përfundimtar.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **24,244,496 lekë**, si më poshtë:

**1 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 539, datë 06.07.2016, në shumën 214,800 lekë, nr. 683, datë 22.08.2016, në shumën 440,000 lekë, nr. 1033, datë 19.12.2016, në shumën 48,600 lekë, nr. 355, datë 18.04.2017, në shumën 534,600 lekë, nr. 407, datë 05.05.2017, në shumën 120,600 lekë, nr. 598, datë 28.06.2017, në shumën 288,000 lekë, nr. 435, datë 18.09.2017, në shumën 723,000 lekë, nr. 593, datë 04.10.2017, në shumën 97,250 lekë, nr. 467, datë 09.10.2017, në shumën 540,600 lekë, nr. 962, datë 09.10.2017, në shumën 419,568 lekë, nr. 1096, datë 20.11.2017, në shumën 59,200 lekë dhe nr. 1097, datë 20.11.2017 në shumën 48,800 lekë ka bërë akomodim të futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar kërkesat për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shuma **3,535,018 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 Për disa ndryshime në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 43-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **214,800 lekë**, sipas Aneksit 6, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.2- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **440,000 lekë**, sipas Aneksit 7, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.3- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **48,600 lekë**, sipas Aneksit 8, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.4- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **534,600 lekë**, sipas Aneksit 9, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.5- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **120,600 lekë**, sipas Aneksit 10, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**



**1.6- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **288,000 lekë**, sipas Aneksit 11, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.7- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **723,000 lekë** sipas Aneksit 12, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.8- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **97,250 lekë**, sipas Aneksit 13, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.9- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **540,600 lekë**, sipas Aneksit 14, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.10- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **419,568 lekë**, sipas Aneksit 15, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**1.11- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **108,000 lekë**, sipas Aneksit 16, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

**Brenda muajit Tetor 2018**

**2 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 338, datë 09.05.2016, në shumën 85.208 lekë, ka hartuar preventivin për objektin: “Riparim, vendosje Pompe dhe 1 bolero 1000 litra pranë fushës së sportit “Egnatia”, duke mos ndërsa nuk ka dorëzuar rezervarin e ujit. Mos dorëzimi i rezervuarit të ujit 1000 litra me vlerë **16,810 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik për buxhetin e bashkisë**, veprim në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, me pikën 19, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Në mënyrë të detajuar në faqen 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për riparim dhe vendosje Pompe dhe bolero uji 1000 litra pranë fushës së sportit “Egnatia”, duke mos zbatuar kërkesat për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, për arkëtimin e shumës **16,810 lekë:**

- në vlerën 5,603 lekë, nga B. P., me detyrë kryetar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
- në vlerën 5,603 lekë, A. K., me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
- në vlerën 5,603 lekë, nga F. M., me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;

**Brenda muajit Tetor 2018**

**3 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 454, datë 07.06.2016, në shumën 745,620 lekë, ka bërë pastrim pusi me kompresor me thellësi 242 ml, ndërsa nuk mund të pastrohet gjithë thellësia e pusit pasi ajo është hapësirë, shuma **174,240 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me nenin 12 pikën 3 germa a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me pikën 41, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për pastrimin e gjithë hapësirë së pusit për arkëtimin e shumës **174,240 lekë:**

- në vlerën 43,560 lekë, nga H. B., me detyrë Sekretarë i Përgjithshëm, në cilësinë e Kryetarit të Entit Prokurues;

- në vlerën 43,560 lekë, nga B. P., me detyrë kryetar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
- në vlerën 43,560 lekë nga A. K., me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;
- në vlerën 43,560 lekë nga F. M., me detyrë anëtar i komisionit të prokurimeve me vlera të vogla;

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**4 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 476, datë 17.06.2016, në shumën 107,746 lekë dhe nr. 477, datë 17.06.2016, në shumën 25,061 lekë, ka paguar punonjësit e policisë bashkiake për orë pune jashtë kohës normale të punës. Bashkia Rrogozhinë, nuk duhet të bënte pagesën për “orë pune mbi kohën normale të punës”, por duhet tu kishte dhënë punonjësve të policisë bashkiake pushimet në ditët e më pasme, shuma **132,802 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me germën c, të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **132,802 lekë**, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**5 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 701, datë 18.07.2016, në shumën 91,800 lekë, ka blerë produkte ushqimore për pritje përcjellje, ndërsa Institucionet shtetërore apo vendore mund të kryej shpenzime për pritje dhe përcjellje, por duke hartuar program pritje për delegacioni, qëllimin i takimit të delegacionit, numri i pjesëmarrësve, kuota e shpenzimit sipas grupeve etj. Preventivi i shpenzimeve për pritje delegacioni miratohet nga titullari i institucionit, shuma **91,800 lekë përbënë shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 3 persona sa paguar padrejtësisht për pritje përcjellje nga fondet e buxhetit të Bashkisë në vlerën **91,800 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 30,600 lekë, nga H. B. me detyrë Sekretarë i Përgjithshëm;
- në vlerën 30,600 lekë, F. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës;
- në vlerën 30,600 lekë, A. D. me detyrë sekretar protokolli.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**6 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 140, datë 14.02.2017 në shumën 167,011 lekë dhe nr. 141, datë 14.02.2017 në shumën 14,491 lekë, për periudhën shtator 2016 shkurt 2017, ka paguar punonjësit e policisë bashkiake për orë pune jashtë kohës normale të punës. Bashkia Rrogozhinë, nuk duhet të bënte pagesën për “orë pune mbi kohën normale të punës”, por duhet tu kishte dhënë punonjësve të policisë bashkiake pushimet në ditët e më pasme, shuma **186,502 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik** për buxhetin e bashkisë, veprim në kundërshtim me germën c, të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34,-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **186,502 lekë**, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**7 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 153, datë 07.03.2016, në shumën 68.800 lekë, ka bërë transportin e futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar tarifën e transportit të udhëtarëve, shuma **68,800 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 66, datë

07.02.2007 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **68,800 lekë**, sipas Aneksit 3, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**8 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 160, datë 09.03.2016, në shumën 646,800 lekë, ka bërë akomodim të futbollistëve (ushqim + fjetje + transport), me procedurën e prokurimit me vlera të vogla duke mos zbatuar kërkesat për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shuma **646,800 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 Për disa ndryshime në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 42-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **646,800 lekë**, sipas Aneksit 4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**9 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, me urdhër shpenzim nr. 472, datë 17.06.2016, në shumën 390.600 lekë, ka bërë transport të futbollistëve me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, duke mos zbatuar tarifën e transportit të udhëtarëve, shuma **390,600 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 “Për tarifën e transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **390,600 lekë**, sipas Aneksit 5, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**10 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Rrogozhinë, për vitin 2016-2017 ka paguar R. B., në listë pagesat e futbollistëve të klubit “Egnatia”, ndërsa R B në të njëjtën kohë është paguar edhe në listë pagesat e Administratës së Bashkisë, pasi sipas strukturës organike është emëruar punëtorë i fushës sportit, **duke u paguar për të njëjtën punë dy herë, shuma 263,550 lekë** (109,700 lekë + 153,850 lekë), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me nenin 4 pika 26, neni 12 pikën 3 germa **dh, e**, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 48-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **263,550 lekë**, nga R. B. punëtorë i fushës sportit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**11 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 dhe muajin Janar 2017, D. P., me detyrë ish-shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhen fletë udhëtimet në lidhje me harxhimin e karburanti prej **4715 litra** me vlerë **772,962 lekë** (757,107 + 83,715), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **772,962 lekë**, nga D. P., me detyrë ish-shofer i administratës sipas Aneksit 17, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**12 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 dhe muajin Janar 2017, R. B., me detyrë punëtor i fushës së futbollit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1400 litra** me vlerë **198,019 lekë** (757,107 + 83,715), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **198,019 lekë**, nga R. B. punëtorë i fushës sportit sipas Aneksit 18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**13 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 – 2017, P. H., me detyrë përgjegjës i Klubit të futbollit “Egnatia”, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2995 litra**, me vlerë **425,558 lekë** (181,396 + 244,162), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 50-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **425,558 lekë**, nga P. H., me detyrë përgjegjës i Klubit të futbollit “Egnatia”, sipas Aneksit 19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**14 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 dhe janar 2017, F. M., me detyrë Përgjegjës i Financës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1510 litra** me vlerë **244,024 lekë** (20,540 + 33,486), **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **244,024 lekë**, nga F. M., me detyrë Përgjegjës i Financës sipas Aneksit 20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**15 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016, S. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Turizmit dhe Sporteve, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2777 litra** me vlerë **425,439 lekë**, **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **425,439 lekë**, nga S. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Arsimit, Turizmit dhe Sporteve sipas Aneksit 21, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**16 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016, M. D. me detyrë inspektor i tatim taksave, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1344 litra** me vlerë **195,136 lekë**, **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **195,136 lekë**, nga M. D. me detyrë inspektor i tatim taksave, sipas Aneksit 22, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**17 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016-2017, A. T., me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **6190 litra** me vlerë **964,448 lekë** (459,983 + 504,465), që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 51-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **964,448 lekë**, nga A. T. me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, sipas Aneksit 23, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**18 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016, B. P. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, ka tërhequr nga magazina karburant, ndërsa bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1050 litra** me vlerë **150,614 lekë** (362,849 + 83,715), që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **150,614 lekë**, nga B. P. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, sipas Aneksit 24 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**19- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016, I. H. me detyrë juriste, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **350 litra** me vlerë **50,579 lekë**, që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **50,579 lekë**, nga I. H. me detyrë juriste sipas Aneksit 25, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**20- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 dhe janar 2017, H. P., Përgjegjës i Sektorit juridik, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **790 litra** me vlerë **120,563 lekë**, që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **120,563 lekë**, nga H. P. Përgjegjës i Sektorit juridik, sipas Aneksit 26, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**21- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 dhe janar 2017, Z. K., me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, për vitin 2016, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1650 litra** me vlerë **239,425 lekë**, që **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **239,425 lekë**, nga Z. K. me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, sipas Aneksit 27 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**22- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2017, E. N., me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **1490 litra** me vlerë **236,317 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **236,317 lekë**, nga E. N. me detyrë Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit sipas Aneksit 28, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**23- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2017, A. C., Inspektor sporti, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **2070 litra** me vlerë **331,856 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **331,856 lekë**, nga A. C. me detyrë Inspektor sporti, sipas Aneksit 29, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**24 Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2017, A. K., me detyrë shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **500 litra** me vlerë **81,900 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**24.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **81,900 lekë**, nga A. K. me detyrë shofer i administratës, sipas Aneksit 30, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**25 - Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2017, A. T., me detyrë shofer i administratës, ka tërhequr nga magazina karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **812 litra** me vlerë **121,264 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**25.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **176,221 lekë**, nga A. T. me detyrë shofer i administratës, sipas Aneksit 31, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**26- Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2017, E. D. ka tërhequr nga magazinës karburant, bashkëlidhur nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me harxhimin e karburanti prej **630 litra** me vlerë **94,084 lekë**, që

**përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**26.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **212,063 lekë**, nga E. D. sipas Aneksit 32, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**27- Gjetje nga auditimi:** Sektori i Financës në Bashkinë Rrogozhinë, për objektin e marrë me qira nga subjekti privat “T. G.” shpk nuk ka llogaritur 20% tvsh me vlerë **17,781 lekë**, si dhe nuk ka llogaritur **tatim në burim në shumën 18,364 lekë** (88,320 lekë x 15%). Shuma **31,612 lekë** (17,781 lekë + 18,364 lekë), **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, veprim në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe pika 31 germa d, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**27.1- Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **31,612 lekë lekë**, nga subjekti privat “T. G.” shpk.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**28- Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e më pas Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin për 11 kontrata, sipas Aneksit 41, për shfrytëzim të fondit pyjorë dhe kullosorë, për sipërfaqen 10.955 ha, për periudhën viti 2014- 2017, në shumën 3,723,940 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, të ndryshuar dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 320,962 lekë, gjithsej **4,044,902 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare **me dëm në buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” dhe kushtet e kontratave (*Trajtuar hollësisht në faqet 102-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**28.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **4,044,902 lekë**, nga 11 subjektet, sipas **Aneksit 41**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**29- Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë janë lidhur kontrata për dhënie me qira të hapësirës së plazhit të ndodhur në plazhin e Spilles, u konstatua se 3 subjekte, për sipërfaqen **6020 m<sup>2</sup>** nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës për vitin 2017, në vlerën 1,204,000 lekë dhe kamat vonesa të llogaritura në vlerën 24,722 lekë, **gjithsej 1,228,722 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare **me dëm në buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratave dhe nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**29.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **1,228,722 lekë**, nga 3 subjektet, sipas **Aneksit 36**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**30- Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë gjatë vitit 2013, janë lidhur kontrata për dhënie me qira e tokave bujqësore të pandara, të një sipërfaqe prej 27.6 ha, u konstatua se 7 fermer, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 188,040 lekë dhe kamat vonesat në vlerën 15,177 lekë, **gjithsej 203,217 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës financiare **me dëm në buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratave dhe nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për

Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin” (Trajtuar hollësisht në faqet 88-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**30.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin e vlerës **203,217 lekë**, nga 7 fermerë, sipas **Aneksit 37**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **Brenda muajit Tetor 2018**

**31. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit*”, Rrogozhinë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të projekt – preventivit të hartuar nga projektuesi, dokumentacionit të dosjes së zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por jo të kryera në fakt në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK në vlerën **7,007,906 pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2417 prot., datë 26.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe OE “C. R. 2008” sh.p.k si dhe me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 (Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**31.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **7,007,906 pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “C. R. 2008” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2417 prot., datë 26.09.2016 me objekt “*Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit*”, Rrogozhinë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK dhe prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

#### **Menjëherë**

**32. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme të Bashkisë Rrogozhine faza 2-3*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të projekt – preventivit të hartuar nga projektues rezultoi një rritje fiktive e fondit limit në vlerën **916,940 lekë pa tvsh** nga të cilat vlera **705,646 lekë pa tvsh** me pasojë dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 (Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**32.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **705,646 lekë** nga ing. A. T., në cilësinë e hartuesit të projekt – preventivit të punimeve në investimit me objekt “*Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme të Bashkisë Rrogozhine faza 2-3*”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit të vënë në dispozicion të investimit.

#### **Menjëherë**

**33. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “*Rikonstruksioni i magjstralit kryesor & rrjetit të brendshëm të ujësjellësit*”, Rrogozhinë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **183,350 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 3208 prot., datë 06.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe OE “I. T. S.” sh.p.k (Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**33.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **183,350 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “I. T. S.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën 3208 prot., datë 06.12.2016 me objekt “*Rikonstruksioni i magjstralit kryesor & rrjetit të brendshëm të ujësjellësit*”, Rrogozhinë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

#### **Menjëherë**



**34. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *“Rehabilitimi i kanaleve ujitës sekondarë Peqin Kavajë, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”*, Rrogozhinë, nga auditimi i dosjes së zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike dhe dokumentacionin shtesë të sjellë nga mbikëqyrësi i punimeve, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në përputhje me situacionin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK në vlerën **507,095 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. Nr. 1566, Datë 04.05.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe “M.” shpk & “N.” sh.p.k (*Trajtuar hollësisht në faqet 74-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**34.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **507,095 lekë pa t.v.sh** nga BOE “M.” shpk & “N.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2417 prot., datë 26.09.2016 me objekt *“Rehabilitimi i kanaleve ujitës sekondarë Peqin Kavajë, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo në përputhje me situacionin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK.

**Menjëherë**

## **B. 1. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1 - Gjetje nga auditimi:** - Bashkia Rrogozhinë, për vitin 2016-2017 ka paguar futbollistët dhe ekipin mbështetës të klubit të futbollit “Egnatia”, pa kontrata pune ose marrëveshje juridiko-civile për shërbimin e ofruar, për të përcaktuar kohëzgjatjen e nevojshme dhe zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga kontrata e punës nga buxheti i Bashkisë në vlerën **21,767,650 lekë** (viti 2016 në shumën 9,187,650 lekë dhe viti 2017 në shumën 12,580,000 lekë), që tregon për mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike, veprim në kundërshtim me nenin 4 pika 26, neni 12 pikën 3 germa **dh, e**, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe nenin 140, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 48-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 - Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa, të eliminojë praktikatat që çojnë në efektivitet të ulët për pagesat e futbollistëve dhe të ekipit mbështetës të klubit të futbollit “Egnatia”, ndërsa pagesat të bëhen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe në përputhje me fondet e planifikuara.

**Në vijimësi**

**2 - Gjetje nga auditimi:** - Për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike **në kundërshtim me kërkesat ligjore në masën 195,420 mijë lekë, të cilat kanë dhënë efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore**, në fushën e prokurimit publik.

**2.a:** Në tenderin me objekt *“Rehabilitimi i kanaleve ujitës sekondarë Peqin-Kavajë në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”*, me fond limit 52,797,097 lekë, zhvilluar në datën 7.4.2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues BO Shoqëria “B. X” shpk & “S.” shpk, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 47,735,768 lekë pa TVSH. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 47,735,768 lekë.**

**2.b:** Në tenderin me objekt *“Shërbimet publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorit dhe varrezave publike në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”*, me fond limit 75,000,000 lekë, zhvilluar në datën 20.7.2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues BO Shoqëria “V. G.” shpk & “B.” shpk, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 74,728,704 lekë pa TVSH. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 74,728,704 lekë.**

**2.c:** Në tenderin me objekt “Studim projektim “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në Bashkinë Rrogozhinë”, me fond limit 18,594,366 lekë, zhvilluar në datën 16.5.2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues BO Shoqëria “I.” shpk & “A. 4” sh.p.k., i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 18,420,000 lekë pa TVSH. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 18,420,000 lekë.**

**2.d:** Në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në Bashkinë Rrogozhinë, vazhdim i lotit të parë”, me fond limit 54,678,194 lekë, zhvilluar në datën 14.2.2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues BO Shoqëria “I. T. S.” shpk & “H.” shpk, i cili nuk plotëson kërkesat e DST, me vlerë të ofertës 54,535,982 lekë pa TVSH. Tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën 54,535,982 lekë** (Trajtuar hollësisht në faqet 57-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet strukturave përkatëse të kryerjes së procedurave të prokurimit publik, të eliminohen praktikat të shpallja fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, pasi kjo shkakton përdorim të fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, pa ekonomicitet eficient dhe efektivitet, për shkak se në këto raste operatorët ekonomik nuk garantojnë realizimin me cilësi të kontratës.

**Në vijimësi**

## **B. 2. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE**

Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se nga Bashkia Rrogozhinë, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme shtrënguese në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 4, 26, 32, 34 dhe të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nenet 40,41, 70, 90, 91, 114. **Totali i të ardhurave të munguara nga mos vjelja e tatim taksave vendore, është në shumën 25,545,423 lekë, nga të cilat:**

- 25,719,216 lekë, debitorë për taksat dhe tarifave vendore të pa paguara nga 262 subjekte të biznesit të vogël dhe 52 subjekte të biznesit të madh.
- 246,640 lekë, 6 subjekte të cilat kanë ushtruar aktivitetin e tyre, pa qenë të regjistruara në QKB dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore (Trajtuar hollësisht në faqet 74-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Rrogozhinë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale.

Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë**

## **C. MASA DISIPLINORE:**

### **C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, shkronja (c) dhe (ç) “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015

“Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:  
**a-“Largim nga Shërbimi Civil”** shkronja (ç) të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil, për **2 punonjësit** e mëposhtëm:

**1-V. D. me detyrë**, agronome në Sektorin e Bujqësisë, në cilësinë e antarit të Komisioni i Qiradhënies të Tokës Bujqësore të Pandarë:

-Për mos zbatimin e procedurave në **16 raste** të dhënies me qira të tokave shtetërore të pandara, **për 99 vjet**, për sipërfaqe **27.6 ha**, në kundërshtim me kërkesat e nenit 5, ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", pikës 4 të vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara", të ndryshuar, kreu II pika 1, 3, 11, kreu IV, germa **c**, të UKM nr 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”. (*Trajtuar në faqet 99-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2- S. D. me detyrë**, Jurist për periudhën 01.01.2016 deri më 01.10.2017 aktualisht Përgjegjës i Sektorit Kadastral dhe Pronave pasi:

-Në procedurën “Për dhënien me qira të hapësirës së plazhit të ndodhur në plazhin e Spilles”, u konstatuan veprime në kundërshtim me kërkesat ligjore, si më poshtë:

nuk është marrë konfirmimin nga ministria përgjegjëse për turizmin nëse hapësira e plazhit të kërkuar është objekt i ndonjë kërkesë që është duke u shqyrtuar apo një kontrate në kuadër të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", mungon dokumentacionit tekniko-ligjore si: plani i biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve, dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, mungon, harta e hapësirës së plazhit të dhënë me qira, procesverbali i marrjes në dorëzim të hapësirës së plazhit, sipas kontratës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 93, datë 27.07.2015 "Për Turizmin", pikat 1, 2, të nenit 64 dhe VKM nr. 369, datë 18.5.2016 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", pika 3, 4, nenit 4, pika 3, 5 të nenit 6 dhe pika 3 e nenit 9 (*Trajtuar në faqet 92-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” e parashikuar në nenin 58 germa (c)**, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil, për **3 punonjësit** e mëposhtëm:

**1 – H. B.**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm cilësinë e Kryetarit të Entit Prokurues për blerjet me vlera të vogla, pasi:

- Për pagesate e kryera për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, pasi nuk duhet të bënte prokurim me vlera të vogla, por duhet të bënte mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë, veprim në kundërshtim me nenit 40 pika 1, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 30, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3, të VKM nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.

- Në 3 raste për pagesën e kryer në lidhje me ndarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Rrogozhinë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

**2 – B. P.,** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në cilësinë e Kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, pasi:

- Për pagesate e kryera për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, pasi nuk duhet të bënte prokurim me vlera të vogla, por duhet të bënte mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë, veprim në kundërshtim me nenin 40 pika 1, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 30, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3, të VKM nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.

- Në 3 raste për pagesën e kryer në lidhje me ndarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Rrogozhinë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

- Për mos zbatimin e proceduarve në marrjen me qira të pasurisë së paluajtshme pronë private në 4 raste, duke mos bërë një analizë financiare kosto-përfitim, në kuptimin e një studimi fizibilitetit, duke krahasuar koston e marrjes me qira + koston e mirëmbajtjes, duke mbajtur në konsideratë diferencën e kostos me çmimin, duke mos përcaktuar kushtet ose termat e referencës për ambientet që marrte me qira me çmimin e referencës për zona të ndryshme të qytetit, si dhe domosdoshmërisht për një proces konkurrues nuk ka bërë publikimi në televizionin lokal, në gazetën më të shitur dhe nuk ka kërkuar të paktën tre oferta përpara vendimmarrjes, veprim në kundërshtim me kreun IV neni 31 pika 1 dhe neni 33, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 29-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Për mos zbatimin e proceduarve, për inventarizimin, regjistrimin, dhënien me qira dhe vënien në efikasitet të pronave të transferuara me VKM, Bashkisë sipas përcaktimeve të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, Udhëzimi nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 84-89, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3 – F. M.,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, pasi:

- Për mos arkëtimin e debitorëve të ndryshëm në vlerën 47,897,308 lekë, në kundërshtim me germa g neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar

-Për mos zbatimin e proceduarve në pagesate e kryera për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, pasi nuk duhet të bënte prokurim me vlera të vogla, por duhet të bënte mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë, veprim në kundërshtim me nenin 40 pika 1, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 30, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3, të VKM nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.

- Në 3 raste për pagesën e kryer në lidhje me ndarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Rrogozhinë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

- Për mos zbatimin e proceduarve në marrjen me qira të pasurisë së paluajtshme pronë private në 4 raste, duke mos bërë një analizë financiare kosto-përfitim, në kuptimin e një studimi fizibilitetit, duke krahasuar koston e marrjes me qira + koston e mirëmbajtjes, duke mbajtur në konsideratë diferencën e koston me çmimin, duke mos përcaktuar kushtet ose termat e referencës për ambientet që marrte me qira me çmimin e referencës për zona të ndryshme të qytetit, si dhe domosdoshmërisht për një proces konkurrues nuk ka bërë publikimi në televizionin lokal, në gazetën më të shitur dhe nuk ka kërkuar të paktën tre oferta përpara vendimmarrjes, veprim në kundërshtim me kreun IV neni 31 pika 1 dhe neni 33, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 29-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:**

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë** fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore

a. **“Zgjidhje të kontratës së punës” për 1 punonjës si më poshtë:**

**1 –A. T.** me detyrë ish- K/inspektor për periudhën 11.09.2016 deri më 05.10.2017 aktualisht inspektor, pasi:

-Për mos ndjekjen e procedurave ligjore për vjeljen e gjobave dhe ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje të konstatuara për periudhën që ka kryer detyrën e K/inspektorit të IMTV, sipas kërkesave të nenit 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” përkatësisht nenet 9, 22 dhe 30, paragrafin 3 të nenit 13, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 52, pika 6 (*Trajtuar në faqet 82-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

b. **“Vërejtje”, për 1 punonjës si më poshtë:**

**1 – A. K.**, me detyrë specialist pagash në cilësinë e natarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla, pasi:

- Për mos arkëtimin e debitorëve të ndryshëm në vlerën 47,897,308 lekë, në kundërshtim me germa g neni 12, të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar

- Për mos zbatimin e proceduarve në pagesate e kryera për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit, pasi nuk duhet të bënte prokurim me vlera të vogla, por duhet të bënte mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare, në bankat e nivelit të dytë, veprim në kundërshtim me nenit 40 pika 1, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 30, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3, të VKM nr. 682, datë 29.7.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.

- Në 3 raste për pagesën e kryer në lidhje me ndarjet kulturore të organizuar nga Bashkia Rrogozhinë, në kundërshtim me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

- Për mos zbatimin e proceduarve në marrjen me qira të pasurisë së paluajtshme pronë private në 4 raste, duke mos bërë një analizë financiare kosto-përfitim, në kuptimin e një studimi fizibilitetit, duke krahasuar koston e marrjes me qira + koston e mirëmbajtjes, duke mbajtur në konsideratë diferencën e koston me çmimin, duke mos përcaktuar kushtet ose termat e referencës për ambientet që marrte me qira me çmimin e referencës për zona të ndryshme të qytetit, si dhe domosdoshmërisht për një proces konkurrues nuk ka bërë publikimi në televizionin lokal, në gazetën më të shitur dhe nuk ka kërkuar të paktën tre oferta përpara vendimmarrjes, veprim në kundërshtim me kreun IV neni 31 pika 1 dhe neni 33, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të

pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar (Trajtuar në faqet 29-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

### **D.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Bashkisë Rrogozhinë**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës** punimesh, si më poshtë:

**1- L. T.**, në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

*a-“Rikonstruksioni i magjstralit kryesor & rrjetit të brendshëm të ujësjellësit”*, me sipërmarrës punimesh OE “I. T. S.” sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **183,350 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

**2-A. N.**, në masën **50,000 lekë** për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

*d-“Rehabilitimi i kanaleve ujitës sekondarë Peqin Kavajë, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”*, me sipërmarrës punimesh BOE “M.” shpk & “N.” sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **507,095 lekë pa t.v.sh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

### **D.2. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **3 punonjësve** si më poshtë:

1. **z. B. P.** (Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse),

2. **z. F. M.** (Përgjegjës i Sektorit të Financës)

3. **z. H. B.** (Sekretar i Përgjithshëm).

Për shkeljet e mëposhtme:

Shkeljet nga **3 anëtarë të KVO për 3 procedura prokurimi janë si më poshtë:**

**1. Në tenderin nr. 2** me objekt: *“Rehabilitimi i kanaleve ujitës sekondarë Peqin-Kavajë në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”* me vlerë 47,735,768 lekë pa TVSH zhvilluar më dt.07.04.2016. Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë me ofertën ekonomike, si më poshtë:

1- BO Shoqëria “B.X” sh.p.k. & “S.” sh.p.k. me ofertë ekonomike 47,735,768 lekë pa TVSH.

2- Shoqëria “S.” sh.p.k. me ofertë ekonomike 47,514,879 lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka marrë vendimin e datës 19.4.2016 për klasifikimin e ofertave dhe renditjen e konkurrentëve. Sipas vendimit është kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori ekonomik pjesëmarrës në tender BO Shoqëria “B.X” sh.p.k. & “S.” sh.p.k.

Është skualifikuar operatori ekonomik pjesëmarrës në tender Shoqëria “S.” sh.p.k për mangësi në paraqitjen e dokumentacionit të kërkesave për kualifikim.

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të operatorit ekonomik fitues BO Shoqëria “B.X” sh.p.k. & “S.” sh.p.k. rezultoi se:

- Shoqëria “S.” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratën për gjendjen gjyqësore, si rrjedhojë nuk është plotësuar kërkesa e pikës 1 të Kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

- Shoqëria “B.X” sh.p.k. ka detyrime fiskale në shumën 9,618,503 lekë. Edhe pse është në proces gjyqësor kjo duhej të ishte vlerësuar nga KVO-ja.

- Nuk është plotësuar kërkesa e germës “b” të pikës 12 të Kërkesave të veçanta për kualifikim, ku nuk janë deklaruar certifikatat ISO për prodhimin e materialeve të ndërtimit që do të përdoren.

**2. Në tenderin nr. 4** me objekt: *“Shërbimet publike të pastrimit, gjelbërimit, dekorit dhe varrezave publike në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”* me vlerë 74,728,704 lekë pa TVSH zhvilluar më dt.20.07.2016 .

Në tender ka marrë pjesë vetëm 1 operator ekonomikë BOE Shoqëria “V. G.” sh.p.k. & “B.” sh.p.k. me ofertë ekonomike 74,728,704 lekë pa TVSH. Nga auditimi i kërkesave për kualifikim i operatorit ekonomik BOE Shoqëria “V. G.” sh.p.k. & “B.” sh.p.k. i shpallur fitues u konstatua se:

- nuk ka plotësuar kërkesën e pikës 2 “Certifikatë e gjendjes financiar”, pasi vërtetimi i paraqitur është për shumën 2,552,000 lekë, nga 3,000,000 lekë që duhej të deklaronte dhe që përbën 40% të vlerës prej 10% të fondit limit, në raport me pjesëmarrjen në tender.

- nuk ka plotësuar kërkesën e pikës 3.3 Kapaciteti teknik, pasi nuk vërteton përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

- nuk ka plotësuar kërkesën e pikës 3.3 Kapaciteti teknik, pasi nuk ka paraqitur liçensën profesionale të shoqërisë me kategorinë kodin III.I.A të lëshuar nga QKL për pastrim, gjelbërim, funeral e mirëmbajtje varrezash.

- Në plotësimin e kapaciteteve teknike mungojnë:

a. Automjet teknologjik për fshirje dhe larje rruge e sheshe

b. Makineri fshesë, me fshesë anësore

c. Kontenierë mbeturinash metalike 250 copë.

**Për mangësitë e mësipërme BO Shoqëria “V. G.” sh.p.k. & “B.” sh.p.k. duhej të ishte skualifikuar dhe tenderi të ishte anuluar për mungesë konkurrence.**

**3. Në tenderin nr. 7** me objekt: *“Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në Bashkinë Rrogozhinë vazhdim i lotit të parë”* me vlerë 54,535,982 lekë pa TVSH zhvilluar më dt.14.02.2017.

Nga auditimi i dokumentacionit kualifikues të operatorit ekonomik “B. B” sh.p.k. rezultoi se ka mangësi dhe se skualifikimi është i drejtë. Për sa i përket dokumentacionit kualifikues të BOE Shoqëria “H.” sh.p.k. & “I.T.S” sh.p.k. të shpallur fitues rezultoi se:

- Shoqëria Shoqëria “I. T. S.” sh.p.k. ka mangësi në dokumentacionin kualifikues pasi i mungon:

a. Vërtetimi për punë të ngjashme;

b. Mungojnë certifikatat ISO 39001:2012, ISO 8000:2014, ISO 50001: 2011, PASS 99:2012, EN-ISO 3834-2:2006 dhe ISO 27001 : 2013;

c. Nuk ka përmbushur kërkesën e pikës 5 të Kapacitetit teknik, pasi Numri mesatar i punonjësve të siguruar për vitin 2015 është 5.6 nga 15 punonjës që duhet të kishte në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në tender.

- Gjithashtu BOE Shoqëria "H." sh.p.k. & "I.T.S" sh.p.k nuk ka plotësuar kërkesën për kualifikim të Kapacitetit teknik të shprehura në pikën 3.6, pikën 3.7 deklarata; pikën 7 pasi mungon certifikata ISO 9001: 2008 që duhet të pajisej prodhuesi i tubove si dhe dokumenti i paraqitur nuk është certifikatë ISO. Për sa më lart, për mangësitë në dokumentacionin kualifikues, BOE Shoqëria "H." sh.p.k. & "I.T.S" sh.p.k **duhet të ishte skualifikuar dhe tenderi duhet të ishte anuluar për mungesë konkurrence.**

Për këtë mban përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në zbatim të nenit 58 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", pasi ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë me mangësi në dokumentacionin kualifikues.

### **D.3. Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. (Heqjen e licencës profesionale)**

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", VKM nr. 759, datë 12.11.2014 "Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit" dhe në nenet 13, 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, "Sanksione dhe Dispozita kalimtare", të "Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit", për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë** Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë:

**1-Heqjen e licencës profesionale, z. V. M., nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës "C. G." shpk.**

Për shkeljet në zbatimin e punimeve në objektin "*Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit Rrogozhinë*", realizuar sipas kontratës nr. 2417, datë 28.09.2016 midis sipërmarrësit "C. R. 2008" sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkia Rrogozhinë, ku nga verifikimi në terren dhe dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit u konstatua se nuk janë kryer 17 zëra punimesh duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë në vlerën **6,781,896 lekë pa tvsh** dhe në lidhje me punimet e realizuara jo sipas specifikimeve të projekt-preventivit, me vlerë **1,285,250 lekë pa tvsh**, konstatohet se: "*Zëri II.4.An F.v pllaka guri natyral t=8cm Dekorativ*", është kryer jo konform specifikimeve teknike, duke vendosur në vepër gur natyral me trashësi t=5 cm dhe jo me trashësi t=8 cm, siç është dhe e parashikuar në preventiv. "*Zëri II D.2. F.v guardrail H3 anësore per ure me 3 vale ne 1 ane, E5 (elem+lart)*", nga verifikimi në terren, konstatohet se është kryer në mospërputhje me preventivin, duke vendosur handrail dhe jo guardrail H3E5 (të paraqitura në mënyrë të detajuar në faqet 74-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me:

-Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 dhe 12.

-Udhëzimin e KM, nr. 3, datë 15.02.2001, "Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, datë 15.02.2001 të KM "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

-Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu II.

-Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm në dosjen teknike.

-Kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, ku përcaktohen detyrimet e mbikëqyrësit.

-Kontratën për kolaudimin e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, ku përcaktohen detyrimet e kolaudatorit.

Mbështetur në Vendimin e KM Nr.42, Datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", Kreu VII, pika III, i rekomandojmë Komisionit të Licencave



**2-Heqjen e licencës profesionale**, shoqërisë “C. R. 2008” shpk, me drejtues ligjor **z. A. K.**, për shkeljet në zbatimin e punimeve në objektin “*Rivitalizimi Urban i Qendrës së Qytetit Rrogozhinë*”, realizuar sipas kontratës nr. 2417, datë 28.09.2016 midis sipërmarrësit “C. R. 2008” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkia Rrogozhinë, ku nga verifikimi në terren dhe dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit u konstatua se nuk janë kryer 17 zëra punimesh duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë në vlerën **6,781,896 lekë pa tvsh**, dhe në lidhje me punimet e realizuara jo sipas specifikimeve të projekt-preventivit, me vlerë **1,285,250 lekë** pa tvsh, konstatohet se: “*Zëri II.4.An F.v pllaka guri natyral t=8cm Dekorativ*”, është kryer jo konform specifikimeve teknike, duke vendosur në vepër gur natyral me trashësi t=5 cm dhe jo me trashësi t=8 cm, siç është dhe e parashikuar në preventiv. “*Zëri II D.2. F.v guardrail H3 anësore per ure me 3 vale ne 1 ane, E5 (elem+lart)*”, nga verifikimi në terren, konstatohet se është kryer në mospërputhje me preventivin, duke vendosur handrail dhe jo guardrail H3E5 (të paraqitura në mënyrë të detajuar në faqet 74-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me:

-Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 8.

-Udhëzimin e KM Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

-Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2417, datë 28.09.2016 lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Rrogozhinë, ku përcaktohen detyrimet e sipërmarrësit.

## **E. KALLËZIM PENAL**

**I.** Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, Vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për tokat bujqësore të pandara”, të ndryshuar, dhe të UKM nr 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, KLSH, ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ish-Titullarin e Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Qiradhënies të Tokës Bujqësore të Pandara si dhe të personave të tjerë, zyrtarë të këtij institucioni.

**II.** Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 12 pika 3 germa (e), neni 7, 8 dhe 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyerjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kap. I, pika 7, KLSH, ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, mbikëqyrësit e punimeve për investimet e realizuara nga institucioni.

## **F. INDICIE PENALE**

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, KLSH, ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe Njësinë e Prokurimit.

**Shënim:** Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, ***Kallëzimi Penal dhe Indicie Penale nuk publikohet.***

## **G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

- Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht:

1. I. G., me detyrë N/Kryetar Bashkie, larguar nga puna me datë 27.07.2015,

2. M. D. me detyrë ish-inspektor taksave larguar nga puna me 22.12.2016,

*Shënim:<sup>1</sup> Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**